



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12 dhe nenit 40, paragrafi 2, shkronja l e Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28 qershor 2008), dhe të nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja a, dhe nenit 34, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.04. 2017, merr këtë

## **VENDIM**

### **PËR RIDESTINIMIN E OBJEKTIT TË VJETËR TË BIBLIOTEKËS "HIVZI SULEJMANI"**

#### **Neni 1**

Miratohet Vendimi për ridestinimin e objektit të vjetër të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në Qendër Edukativo-Artistike.

#### **Neni 2**

Objekti i vjetër i bibliotekës "Hivzi Sulejmani", i cili ridestinohet në Qendër Edukativo-Artistike, gjendet në adresën: rruga "UÇK", nr. 10, 10000, Prishtinë, me sipërfaqe prej 1082 m<sup>2</sup>, me nr. të parcelës 4845-0 dhe certifikatë të pronës P-71914059-04845-0.

#### **Neni 3**

Me ridestinimin e objektit të vjetër të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në Qendër Edukativo-Artistike nga neni I i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi kulturor dhe artistik.

#### **Neni 4**

Bartës për ridestinimin e objektit të vjetër të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në Qendër Edukativo-Artistike, është Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 5**

Mjetet për ridestinimin e këtij objekti në Qendër Edukativo-Artistike, janë të siguruar nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

## Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

## Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

01-660/11-0093828/17, më 24.04.2017



**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Halma Halimi, jur. i dipl.**